

Dream Construzioni Generali Shpk
Pasqyrat Financiare me 31 dhjetor 2016

Permbajtja:

	Faqe
Bilanci kontabel me 31 dhjetor 2016	2
Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016	4
Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfaqshuese per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016	5
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016	6
Pasqyra e flukseve monetare per periudhen nga 26 Ttor2016 deri me 31 dhjetor 2016	7
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare	8-15

Dream Construzioni Generali Shpk

Bilanci kontabel

per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

Pasqyrat financiare te shoqerise me 31 dhjetor 2016 dhe per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016 u aprovuan Dream Construzioni Generali sh.p.k dhe u nenshkruan si me poshte:

Giorgio Scardoni

Z. Giorgio Scardoni
Perfaqesues ligjor



Z. Guglielmo Abbate
Perfaqesues ligjor

Abbate *Scardoni*

Bilanci kontabel duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 8 – 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Dream Construzioni Generali Shpk**Bilanci kontabel**

per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2016
<u>Aktivet</u>		
I. Aktivet afatshkurtra		
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	4	299,222
Llogari te tjera te arketueshme	5	782
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		300,004
II. Aktivet afatgjata		
Instalime teknike		-
Totali i aktiveve (I + II)		300,004
<u>Detyrimet dhe kapitali</u>		
I. Detyrimet afatshkurtra		
Te pagueshme ndaj punonjesve	6	109,046
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		109,046
II. Detyrimet afatgjata		
Detyrime afatgjata	7	28,000
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		28,000
Totali i detyrimeve (I + II)		137,046
III. Kapitali neto		
Kapitali fillestar	8	350,000
Fitimi i periudhes		(187,042)
Totali i kapitalit (III)		162,958
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		300,004

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 8 – 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Dream Construzioni Generali Shpk**Bilanci kontabel**

per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

	Shenime	Periudha nga 26 Tetor deri me 31 Dhjetor 2016
Te ardhurat nga aktiviteti		
Te ardhurat nga shitja e sherbimeve		0
		<u>0</u>
Shpenzimet operative		
Shpenzime sherbimi	9	(28,000)
Shpenzime personeli	10	(143,308)
-pagat e personelit		(122,800)
-kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore		(20,508)
Shpenzime sherbimi bankar	11	(4,934)
Totali i shpenzimeve operative		<u>(176,242)</u>
Fitimi nga veprimtaria kryesore		<u>(176,242)</u>
Te ardhura nga kursi I kembimit	12	
Shpenzime nga kursi I kembimit	13	(10,800)
Totali i te ardhurave financiare - neto		<u>(10,800)</u>
Fitimi para tatimit		<u>(187,042)</u>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		<u>0</u>
Fitmi i periudhes		<u>(187,042)</u>

Dream Construzioni Generali Shpk

Bilanci kontabel

per periudhen nga 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

Pasqyra e ndryshimit ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 8 – 15qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

	Rezerva nga konvertimi i monedhave te huaja		Rezerva te tjera	Fitime(Humbje) te akumuluar	Fitimi(humbje) e vitit	Totali
Kapitali	monedhave te huaja					
Kapitali themeltar	350,000	-	-	-	-	350,000
Dividend i paguar	-	-	-	-	-	0
Humbja neto e periudhes	-	-	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2016	350,000	-	-	-	(187,042)	(187,042)
					(187,042)	162,958

Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 8 – 15qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

	31 Dhjetor 2016
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	
Fitimi i periudhes	(187,042)
Rregullime per:	
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	0
Amortizimi	0
Provizione	
Shpenzime per interesa	
Humbje nga kembimi te parealizuara	
Fitimi operativ para ndryshimeve ne kapitalin punues	(187,042)
Renie\(\rritje) ne llogarite e arketueshme	(782)
Rritje\(\renie) ne llogari te pagueshme	
Rritje\(\renie) ne detyrime te tjera	
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit	
Parapagime per garanci	
Parapagime te dhena	
Parapagime te marra	
Interesi i paguar	
Tatim fitimi i paguar	
Fluksi neto monetar perdorur ne veprimtarite e shfrytezimit	
II. Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit	
Blerje aktiveve afatgjata	-
Blerje investime financiare	
Fluksi neto monetar perdorur ne veprimtarite e investimit	-
III. Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit	
Kapital fillestar	350,000
Te ardhura nga huamarrje afatgjate	28,000
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit	378,000
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	378,000
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	-
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	299,222

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

1. Informacion i pergjithshem

Dream Construzioni Generalish.p.k (ne vijim referuar si “shoqeria”) eshte e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me 26/10/2016 si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Shoqeria eshte e regjistruar me Drejtoria Rajonale Tirane, me NIPT/NUIS L62228027H

Shoqëria ka si objekt : Kryerja e punimeve ne ndertim
.Ortaket e shoqerise jane:

Z.Giorgio Scardoni me 50% te kuotave.

Z.Guglielmo Abbate me 50% te kuotave.

Perfaqesuesit ligjor te shoqerise jane

Z.Giorgio Scardoni.

Z.Guglielmo Abbate.

Adresa e Shoqerise eshte TIRANE Rruga Andon Zako Cajupi, ndertasa 6

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2016 eshte 2

2 Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) ne Shqiperi.

Drejtimi i shoqerisevlereson qe shoqeria do te vijoje aktivitetin normal tregetar per 12 muajt qe pasojne muajin e mbylljes se ketyre pasqyrave financiare. Per rrjedhoje, sipas parashikimeve te Ligjit Nr. 9228, date 29 prill 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pasqyrat financiare per vitin ushtrimor 2016 jane pergatitur ne baze te parimit te vijimesise.

Bazuar ne SKK 11 “Tatimi mbi te Ardhurat”, paragrafi 4, shoqeria ka vendosur te mos njohe tatimet e shtyra ne pasqyrat e saj financiare.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, qe eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

2.4 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te kompanise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken nga rivleresimi.

Ne vecanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare. Perdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal neketo pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtesine e veprimeve te realizuara nga shoqeria.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente ne periudhen qe fillon me 26 Tetor 2016 deri me 31 dhjetor 2016.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit.

Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Tedrejtat dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehene ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi kembimi me date 31.12.2016 eshte 135.23 leke/euro.

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe llogari te pagueshme.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, pervec siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare jo-derivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktiviteti financiar ose kur shoqeria transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbeshore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qeshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

tesheseaktivin. Detyrimet financiare qregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraaja dhe ekuivalentet te sajperfshejne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbriturhumbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare tedeбитorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa ne pagesakonsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhenanjihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve qdo difference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarries duke u bazuar ne interesin efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere jo-derivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur qdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, qdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Aktive ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te njeaktivit afatgjate materialkane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera tendryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mepashme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qeshoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivt duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivt afatgjate material dhe duke marre per bazeperiudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivt. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo dateraportimi.

3.4 Zhvleresimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivt.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si difference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivt financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivt e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet nepasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivt financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4 Zhvleresimi (vazhdim)

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare te Deges, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivt.

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlere e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Nje provizion njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje normeskontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve nevarësite fazesë perfundimit te transaksionit ne daten e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtavedhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e periudhes, i cili njihet drejtperdrejt ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhes eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore temiratuara neperiudhen e raportimit.

4. Mjete Monetare

Mjete monetare me 31 dhjetor 2016 jane perbere si me poshte:

Mjete monetare

	31 Dhjetor 2016
Banka	-2,500
Vlera monetare ne leke	
Banka EUR	301,722
Shuma	299,222

*(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)***5.Llogari te pagueshme**

Kerkesa te arketueshme deri me 31 dhjetor 2016 jane perbere si me poshte:

Kerkesa te arketueshme të tjera

	31 Dhjetor 2016
Te drejta te arketueshme	782
Shuma	782

6. Detyrime personeli

Detyrimet e personelit deri me 31 dhjetor 2016 jane si me poshte:

Te pagueshme ndaj personelit

	31 Dhjetor 2016
Paga dhe shpërblime	109,046
Shuma	109,046

7.Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata deri me 31 dhjetor 2016 jane si me poshte:

Detyrime afatgjata

	31 Dhjetor 2016
Detyrime afatgjata	28,000
Shuma	28,000

8.Kapitali i vet

Kapitali i vet deri me 31 dhjetor 2016 eshte perbere si me poshte:

Kapitali i vet

	31 Dhjetor 2016
Kapitali fillestar	350,000
Fitimi/Humbja e periudhes	(187,042)
Shuma	162,958

*(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)***9.Shpenzime per sherbime**

Shpenzimet per sherbime deri me 31 dhjetor 2016 jane te perbera si me poshte:

*„Shpenzime per sherbime***Periudha nga 26 Tetor
deri me 31 Dhjetor 2016**

Sherbim sherbimi	(28,000)
Shpenzime për shërbimet bankare	(4,934)
Shuma	(32,934)

10.Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit jane perbere si me poshte:

*„Shpenzime personeli***Periudha nga 26 Tetor
deri me 31 Dhjetor 2016**

Paga	(122,800)
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	(20,508)
Shuma	(143,308)

11.Te ardhura /shpenzime nga kembimi

Te ardhura /shpenzime nga kembimet gjate vitit 2016 rezultojne si me poshte:

*Te ardhura/shpenzime nga kembimi***Periudha nga 26 Tetor
deri me 31 Dhjetor 2016**

Te ardhura nga kembimet	
Shpenzime nga kembimet	-10,800
Shuma	(10,800)

*(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)***15.Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Per vitin e mbyllur me 31.12.2016 shpenzimi i tatim fitimit eshte 0 pasi shoqeria rezulton me nje humbje fiskale -159,042leke.

Fitimi kontabel (humbja)	(187,042)
Shpenzime te panjohura sipas ligjit fiskal	-
Shpenzime perfaqesimi	(28,000)
Totali i shpenzimeve te panjohura	(28,000)
Totali i rregullimeve nga kontabiliteti te fitimi(humbja) fiskale	(159,042)
Tatim fitmi per vitin 2016	

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin eshte 15% per vitin periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2016.

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore

shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Llogaritja e tatim fitimi eshte kryer ne baze te te ardhurave dhe shpenzimeve te realizuara nga Dream Construzioni Generali Shpk

16 Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit normal te biznesit, shoqeria mund te perfshihet ne pretendime te ndryshme nga te trete dhe masa ligjore. Vecanerisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri ne fuqi ose qe konsiderohet si i hyre ne fuqi ne fund te periudhes raportuese, eshte objekt i interpretimeve te ndryshme per sa i perket zbatimit te tij per transaksionet dhe aktivitetet e Deges. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndermarre nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbeshket qendrimet tatimore mund te kundërshtohet me sukses nga autoritetet perkatese. Periudhat fiskale mbeten te hapura per shqyrtim nga autoritetet per pese vite kalendarike para vitit te shqyrtimit.Nen rrethana te caktuara shqyrtimet mund te mbulojne periudha me te gjata.

Me 31 dhjetor 2016, shoqeria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale te kontraktuara por ende te papaguara.

(shumat ne Lek, nese nuk eshte specifikuar ndryshe)

17. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.